



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:149221

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05803113

P.nr. 157/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurës N. H., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 2 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2367/2024, të datës 22.05.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 10.06.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Vjosa Bytyqi dhe e pandehura, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura,

N. H., e bija e Xh. dhe H., e gjinisë Z., e lindur më datën ... në O., me vendbanim në fshatin "B." Komuna P., e pamartuar nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, amvise, me numër personal ..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

Me datë 20.04.2024 rreth orës 19:20 në lokalin e rrobave "N. Y.", i cili gjendet në rrugën "Z. P." në P., e pandehura, me dashje dhe me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka shkuar në lokalin e lartcekur ku kishte hyrë në zhveshtore për të provuar rroba dhe kishte lënë një parë pantolla të veshura në vlerë prej 20€ nën rrobat e saj dhe ashtu kishte tentuar të dalë nga lokali por e njëjta ishte vërejtur dhe ndaluar nga menaxheri ku kishte njoftuar policinë, me ç' rast të dëmtuarës i kanë shkaktuar dem material,-

- me këtë e pandehura ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 313 par. 2 të KPRK, si dhe në bazë të 242, 364, 365, 367, 452 dhe 462 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumën prej **150 Euro (njëqind e pesëdhjetë)**, të cilin dënim e pandehura detyrohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë,

II. Nëse e pandehura nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

III. Detyrohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV. I dëmtuari L. B. nga fshati L. komuna P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.2367/2024, të datës 22.05.2024, kundër të pandehurës N. H., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata më datën 28.05.2024 nga Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar parashtrësën për korrigjimin e aktakuzës ashtu që tani e tutje kjo aktakuzë do të jet Vjedhja nga neni 313 par. 2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.06.2024 në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Vjosa Bytyqi dhe e pandehura ndërsa mungon i dëmtuari L. B. i cili është ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi bindet se e pandehura e kupton aktakuzën, të njëjtës në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-së i ofrojë mundësinë e deklaramit të saj rreth fajësisë-të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet e pafajshme.

E pandehura me rastin e deklaramit të saj rreth fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar, në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: E pranoj fajësinë, është e vërtetë si në aktakuzë, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, jam penduar shumë, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, dhe i premtoj gjykatës se më nuk do të përsëris veprime të tilla.

Gjykata vërteton se e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e pandehura, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes

që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit ka dhënë mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga e pandehura dhe deklaroi se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë dhe është i bazuar në shkresat e lëndës. Pranimi i fajësisë është në përputhje me dispozitat ligjore, dhe ka bazë edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga e pandehura si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par. 2 të KPPRK-së, aprovoi pranimin e fajësisë nga e pandehura në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 par. 6 të KPPRK-së vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurës përmbushen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Vjedhje nga neni 313 par. 2 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjëse, të njëjten e shpalli fajtores dhe i shqiptoi sanksionin e paraparë ligjor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se e akuzuara gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar shumë, ka premtuar se më nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata, ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe se, me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e saj, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 pika 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 157/24 dt. 10.06.2024

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.